

ASC-10-0081

Në padinë e

[REDACTED], Klinë

Paditësi/Ankuesi

kundër

1. Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)

adresa: Rr. Ilir Konushevci Nr. 8, Prishtinë

Të Paditurit

2. NSH-së [REDACTED]

Klinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 01 dhjetor 2010, lëshon këtë

AKTVENDIM

- 1. Ankesa e Paditësit refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Aktvendimi i DHPGJS-së i datës 4 tetor 2010 për SCC-10-0062 vërtetohet.**
- 3. Ankuesi obligohet ta paguajë shumën prej 40 eurove tek DHPGJS-ja si taksë gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 02 prill 2010, Paditësi e parashtroi një padi pranë DHPGJS-së duke kërkuar njohjen e të drejtës pronësore të tij lidhur me pronat e paluajtshme të regjistruara si ngastra kadastrale Nr 1/8 me një sipërfaqe prej 1.09.85 ha dhe ngastra kadastrale Nr 1/1 (tani 1/18) me një sipërfaqe prej 0.30.00 ha në fshatin Resnik në zonën

II

kadastrale të Dushit, Komuna e Klinës, fleta poseduese Nr. 71006015-00103. Ai gjithashtu ka kërkuar nga DHPGJS-ja që e njëjta të regjistrohet në regjistrat kadastral.

Përveç kësaj, Paditësi i kërkoj DHPGJS-së që ta lëshojë një masë të përkohshme për t'i ndaluar të Paditurit ta tjetërsojë ose të marrin çfarëdo veprimi tjetër lidhur me objektin e këtij kundërshtimi derisa DHPGJS-ja ta lëshon Aktvendimin përfundimtar.

Si dëshmi të pretendimeve të tij, Paditësi e paraqiti një certifikatë për të drejtat pronës së paluajtshme si dhe Aktvendimin e Komisionit Komunal të Klinës të datës 26 shkurt 1970.

Më 13 prill 2010, DHPGJS-ja kërkoj nga Paditësi t'i dorëzojë përkthimet e dokumenteve shtesë, dëshmi se ai e ka bërë njoftimin për qëllimin e tij për ta parashtruar një padi ndaj Agjencisë dhe dëshminë e trashëgimisë.

Më 26 prill 2010, Paditësi e paraqiti një certifikatë të vdekjes lidhur me paraardhësin e pretenduar të tij.

Më 22 qershor 2010, DHPGJS-ja vazhdimisht ka kërkuar sqarime nga Paditësi gjithashtu duke synuar atë nëse ai dëshiron të paraqesë dokumente shtesë për ta mbështetur kërkesën e tij për lëshimin e masës së përkohshme.

Më 8 korrik 2010, Paditësi u përgjigj por nuk parashtroi asnjë dëshmi shtesë.

Më 19 korrik 2010, DHPGJS-ja e dorëzoi kërkesën për masën e përkohshme tek të Paditurit.

Më 29 korrik 2010, i Padituri i 1-rë i kërkoj DHPGJS-së ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Më 4 tetor 2010, DHPGJS-ja e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme si të pabazuar. Trupi Gjykues pohoi se Paditësi nuk arriti të paraqesë dëshmi të besueshme se do të shkaktohej dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm nëse nuk lëshohej masa e përkohshme.

III

Më 27 tetor 2010, Paditësi ushtroi një ankesë duke kërkuar nga Kolegji i Ankesave që ta anulojë aktvendimin e Trupit Gjykses dhe ta miratojë kërkesën për masën e përkohshme. Në ankesën e tij, Ankuesi pohoi se ai di për disa raste ku Agjencia e ka shitur tokën nën pronësinë private, dhe edhe pse nuk ka rrezik të menjëhershëm që kjo të ndodhë, megjithatë ai dëshiron që të drejtat e tij të mbrohen.

Më 4 nëntor 2010, DHPGJS-ja i kërkoi Ankuesit ta sqarojë ankesën e tij lidhur me argumentet ligjore mbi të cilat ai e mbështetë ankesën e tij, duke e cituar Nenin 60.1 lit c UA e UNMIK-ut 2008/6 dhe, në vazhdim, Nenet 353-356 të LPK-së.

Ankuesi më 17 nëntor 2010 paraqiti një parashtresë ku ai pohon se Gjykata duhet ta dijë se LPK-ja nuk është më në fuqi. Ai nuk jep asnjë shpjegim tjetër se cilat janë argumentet ligjore të cilat ai i ngrit për ta kundërshtuar aktvendimin e ankimuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave vendosi që ta refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Kriteret se kur duhet të jepet një masë e përkohshme janë të përcaktuara në Nenin 55.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, siç ceket më lartë: Pala duhet të paraqesë dëshmi të besueshme se do të shkaktohej humbje apo dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm nëse nuk lëshohet kërkesa. Këto kritere janë të përcaktuara në atë mënyrë që nëse mungon ndonjëra nga të mësipërmet atëherë kërkesa mohohet.

Kërkesa e dëshmimeve të besueshme përfshinë të dyja, *fumus boni iuris* (mundësia që e drejta e pretenduar ekziston) dhe *periculum in mora* (rreziku i menjëhershëm për këtë të drejtë), pasi që humbja ose dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse në të vërtetë e drejta e pretenduar ekziston.

Me fjalë të tjera: paditësi/kërkuesi i cili e kërkon masën e përkohshme duhet ta vërtetojë se është e mundshme, se 1. e drejta për të cilën ai pohon se është rrezikuar

IV

ekziston dhe 2. se kjo e drejtë është në rrezik të menjëhershëm për humbje ose dëmtim të riparueshëm, nëse nuk lëshohet masa e përkohshme e kërkuar.

Kjo dëshmi e cila kërkohet që të paraqitet nga paditësi/kërkuesi nuk duhet të kuptohet si një dëshmi e plotë (*probatio plena*) në kuptim të asaj të cilën ai duhet ta paraqet që të jetë i suksesshëm me padinë e tij kryesore. Nëse ai do, dhe nëse ai është në gjendje që ta sjellë këtë dëshmi të plotë, kjo patjetër se do të rekomandohej shumë. Por për ta lëshuar një masë të përkohshme mjafton nëse Paditësi vetëm dëshmon në kuptim të *probatio semiplena* një mundësi të lartë se padia e tij është e bazuar, përkatësisht, se e drejta e pretenduar ekziston. Për ta vërtetuar këtë gjendje të mundësisë së lartë mjafton për shembull referimi tek dokumentet, origjinaliteti i tyre i parashikuar në këtë fazë të procedurës, nga të cilat mund të ngrihet e drejta e pretenduar. Në ato raste, gjithashtu edhe barra e dëshmisë duhet që të merret parasysh. Nëse Paditësi është në gjendje që t'i sjellë dokumentet e kërkuara të cilat e vërtetojnë të drejtën e pretenduar në një pikë të caktuar kohore (ose nëse madje është e pakontestueshme), barra e dëshmisë për një ndryshim të mëvonshëm në këtë të drejtë mund të jetë me të Paditurin. Sidoqoftë, vërtetimi apriori i atyre fakteve nga pikëpamja e mundësisë së lartë nuk e ndalon gjykatën që më vonë të vijë tek një përfundim tjetër gjatë shqyrtimit kryesor. Gjykata, me vërtetimin e fakteve të caktuara për qëllimin e procedurës gjyqësore lidhur me masën e përkohshme, në asnjë mënyrë nuk është e lidhur nga ky vërtetim nga procedura gjyqësore vijuese, pasi që shumë lehtë mund të përcillet nga natyra paraprake e një mase të tillë. Nëse nuk ka arsye të veçanta të tjera që i shtohen këtij vërtetimi të pastër procedural, një anim i gjykatës drejt njëres nga palët nuk mund të hiqet nga aktvendimi për masën e përkohshme.

Lidhur me *periculum in mora* duhet të theksohet në parim se asnjë dëm "i riparueshëm" nuk mund të del për palën – *per definitionem* – si pasojë e dështimit të palës tjetër për ta paguar borxhin, i cili gjithnjë mund të kompensohet *per equivalentem* (p.sh., me pagesën e shumës së njëjtë të parave, plus intereset, pas aktgjykimit përfundimtar), sepse vetë dëmi është "i riparueshëm" me kompensim, përveç - në raste të jashtëzakonshme, të vërtetohet në mënyrë strikte nga Paditësi - i përmbartuari nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për ta kryer obligimin e tij (kjo mund të ndodhë, për shembull, për një kompani e cila ka falimentuar, për një person të pa punë etj.). Tani duhet të theksohet qartë se institucioni ligjor i masës së përkohshme nuk e ka për qëllim ta sigurojë zbatueshmërinë e një aktvendimi të

mundshëm në të ardhmen nga ana e gjykatës për dhënien e dëmeve, por vetëm për ta shmangur një ndryshim të pakthyesëm në statusin ligjor ose faktik të së drejtës ose posedimin që është objekt i padisë kryesore me të cilën duhet të merret gjykata. Prandaj, pretendimet monetare nga natyra e tyre e veçantë, si rregull i përgjithshëm, nuk mund të konsiderohen që të jenë objekt i humbjes ose dëmit të pariparueshëm (ASC-09-0035). Kur është fjala për përjashtimet e mësipërme nga kjo rregull e përgjithshme, nuk mund të lëshohet një masë e përkohshme e cila e jep "kënaqësinë paraprake" të kërkuarit, por mund të urdhërohet vetëm ngrirja e aseteve të caktuara të veçanta, natyrisht vetëm nëse nga kërkuari bëhet një depozitë e mjaftueshme në pajtim me Nenin 55.4 e UA-së së UNMIK-ut (ASC-10-0017).

Paditësi nuk ka dhënë asnjë dëshmi në mbështetje të kërkesës së tij. Ai fare nuk ka treguar në këtë moment të caktuar se posedimi i tij do të rrezikohet nga veprimet e të Paditurve. Ai nuk ka paraqitur – dhe madje ai as nuk ka pohuar - asnjë tregues, për shembull likudimin ose privatizimin e planifikuar të NSH-së, i cili mund të kuptohet si një ndryshim i rëndësishëm që do të mund të çonte në nevojën e lëshimit të një mase të përkohshme të tillë.

Përveç konsideratave të mësipërme, humbja ose dëmi i mundshëm do të duhej të ishte i pariparueshëm, që nuk duket të jetë fakti në rastin në fjalë. Humbja (e mundshme) e posedimit nuk duhet të konsiderohet si e pariparueshme.

Duke pasur parasysh *fumus boni juris*, Paditësi vetëm pohon se ai e ka posedimin e pashqetësuar të tokës por ai nuk jep asnjë dëshmi (në kuptim të përshkrimit të mësipërm) lidhur me titullin e pronësisë së tij.

Duke i përmbyllur argumentet e cekura më lartë, pasi që asnjë nga kriteret e nevojshme për ta lëshuar një masë të përkohshme të përcaktuar nga dispozita e cituar e ligjit nuk është përmbushur, aktvendimi i Trupit Gjykuar për refuzimin e masës së përkohshme të kërkuar vërtetohet.

Shpenzimet:

Sipas Nenit 11 të RREG 2008/4 dhe Nenit 66 të UA-së 2008/6, Trupi Gjykuar merr vendim lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurës gjyqësore në shkallën e parë

VI

dhe Kolegji i Ankesave – kur vendos për një lëndë përfundimisht – lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurave gjyqësore në të dyja shkallët.

Në bazë të Nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 Dhoma e Posaçme ka lëshuar Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore, në fuqi prej datës 30 qershor 2010. Aty thuhet si në vijim:

'Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 27.11.2008, lidhur me "Tarifat e Taksave Gjyqësore" – me specifikimet e mëposhtme – shpallet të jetë i zbatueshëm për procedurat gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri te Neni 10.23 janë të zbatueshëm – mutatis mutandis – për procedurën ankimore para Trupit Gjykues dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, Neni 10.11 është i zbatueshëm edhe për procedurën që drejton ankimin kundër aktvendimeve të shkallës së 2-të të Trupit Gjykues.

(...)

Këto rregulla mbulojnë dhe janë të zbatueshme për të gjitha operacionet nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme-ja nga data 1 janar 2010 dhe janë të vlefshme deri më 31 dhjetor 2010.'

Taksat gjyqësore në të dyja shkallës përbëhen nga, në njërin anë një taksë për ushtrimin e parashtresës(ave), në anën tjetër nga një taksë për lëshimin e (një) aktvendimi(eve).

Pasi që aktvendimi i shkallës së parë ishte lëshuar para ditës së hyrjes në fuqi të rregullave të lartpërmendura, këtu do të merret vetëm me taksat gjyqësore për procedurën ankimore:

Shuma e taksës për ushtrimin e ankesës siç përcaktohet me Nenin 10.11 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ") është 30 euro.

VII

Shuma e tarifës për lëshimin e aktvendimit e caktuar nga Nenet 10.17, 10.12 dhe 10.1 të ADJ-së duhet të përcaktohet në pajtim me vlerën e padisë. Vlera e padisë është 2.000 euro. Tarifa për aktvendimin e shkallës së parë për paditë në mes 1.000 euro dhe 2.500 euro është 20 euro. Taksa gjyqësore lidhur me masën e përkohshme është 50% e shumës e cila do të paguhej për aktvendimin e shkallës së parë.

Bazuar në atë se çfarë u tha më lartë, Paditësi duhet ta paguajë shumën e përgjithshme prej 40 eurove (duke u bazuar në vlerën e padisë së tij prej 2.000 euro).

Në përgjithësi, taksa gjyqësore duhet të paguhet nga pala e cila e humb rastin, me përjashtim të atyre rasteve kur lënda duhet të rigjykohet nga Trupi Gjyqësor (ose, kur Kolegji i Ankesave vepron si shkalla e tretë, qoftë nga Gjykata Komunale qoftë nga Trupi Gjyqësor). Në ato raste, shpenzimet duhet të barten përkohësisht nga ana e Ankuesit dhe ndarja përfundimtare e shpenzimeve i takon Trupit Gjyqësor në aktvendimin e tij të ri. Në rastet sikur ky në fjalë, ku Kolegji i Ankesave përfundimisht e refuzon kërkesën për masën e përkohshme, shpenzimet duhet të paguhet nga ai i cili e ka kërkuar masën e përkohshme.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues

EULEX

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar

EULEX

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar

Tobias Lapke, Regjistruar

EULEX
